



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Punë/Prostatë Received/Delivered	24.04.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	SKPMBJK	3776/2023	113
Shoqja Prilog Appendix			
Sasia Kohësia Quantity			



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.476/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.476/2023 të datës 09.03.2023 të parashtruar nga kundër organit të punësimit Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.04.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.476/2023 e datës 09.03.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 09.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës lidhur me rishikimin e Konkursit me numër reference RN00010772 për emërimin e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm/ Zyrtar për Biblioteka 1, i shpallur nga Komuna e Prishtinës, me pretendimin ankimor së konkursi është përcjell me parregullsi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (me tej referuar vetëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 27.03.2023 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë ankimore.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2523/2023 të datës 09.03.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 21.02.2023 nga ...për...; Vendimin e datës 20.02.2023 të.....; Shkresën lidhur me rezultatet e verifikimit paraprak; Shkresën lidhur me rezultatet e verifikimit paraprak; Njoftimin e datës 05.03.2023 të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; Njoftimin për ndryshimin e orës së mbajtjes së testit; Formularin për kërkesë apo ankesë; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2733/2023 të datës 16.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 3045/2023 të datës 27.03.2023; Konkursin e datës 17.01.2023 me numër të referencës RN00010772 për pozitën e punës Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Vendimin me numër 14-020/04-0047502/23 të datës 06.03.2023 për përbërjen e komisionit të pranimit në shërbim civil; listën e aplikantëve me numër të referencës RN00010772; Aplikacionin e datës 10.02.2023 të kandidatës Diplomën me Nr.2518 të datës 18.11.2014 të kandidatës Diplomën me Nr.689 të datës 11.12.2018 të.... Certifikatën e datës 13.04.2022 lidhur me përfundimin e trajnimit nga Qendra për Aftësi Profesionale të... Vërtetimin e datës 07.02.2023 me të cilën dëshmohet se ankuesja nuk ka dosje penale në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës; Emailin e datës 28.02.2023 të drejtuar; Emailin e datës 28.02.2023 të drejtuar Emailin e datës 28.02.2023 të drejtuar Njoftimin e datës 03.05.2023 të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës drejtuar ankuses; Emailin e datës 06.03.2023 të drejtuar lidhur me ndarjen e grupeve të aplikantëve; Listën e aplikantëve për grupin Nr.3 me gjithsej pesëmbëdhjetë (15) kandidatë; Listën e aplikantëve për grupin Nr.3 me gjithsejtë pesëmbëdhjetë (15) kandidatë; Listën e aplikantëve për grupin Nr.2 me gjithsejtë pesëmbëdhjetë (15) kandidatë; Listën e aplikantëve për grupin Nr.4 me gjithsejtë pesëmbëdhjetë (15) kandidatë; Listën e aplikantëve për grupin Nr.5 me gjithsejtë pesëmbëdhjetë (15) kandidatë; Njoftimin e datës 03.06.2023 të Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit për ndryshimin e orës së mbajtjes së testit me shkrim; Shkesën e shkëputur nga SMBNJ lidhur me dëshminë e aplikimit të ankuses; Vërtetimin nën shenjë 4A.27AE53FDSC406 të datës 24.01.2023; Emalin e datës 19.04.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Formulari për kërkesën apo ankesën e datës 09.03.2023; Ankesën e datës 09.03.2023 të ankuses drejtuar Komunës së Prishtinës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuses është e pa lejuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë së Komuna e Prishtinës më datë 17.01.2023 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00010772 për emrin e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm Zyrtar për Biblioteka, klasa profesional 1, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesja

Me tej nga shkresat e lëndës Kolegji gjen së ankuesja është përfshirë në listën e ngushtë më c ç'rast e njëjta ishte ftuar më datë 05.03.2023 për pjesëmarrje në testin më shkrim, ndërsa me datë 06.03.2023 ankuesja ishte informuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës lidhur me ndryshimin e kohës së testimit, mirëpo që të njëjtës nuk i është lejuar pjesëmarrja në testin me shkrim, me arsyetimin e organit të punësimit së ankuesja ka qenë pjesë e grupit të orës 11:00.



Ankuesja më datën 09.03.2023 ka parashtruar ankesë në Komunën e Prishtinës, si dhe në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimet së Konkursi me numër reference RN00010772 për Specialist i Administrimit të Përgjithshëm në Komunën e Prishtinës është përcjell me parregullsi dhe së ankuesja vetëm 24 ore para mbajtjes së testit me shkrim ishte njoftuar me ndryshimin e orarit të mbajtjes së testit.

Bazuar në provat shtesë të dërguara nga pala ankuese, nuk është vërtetuar fakti së organi i punësimit të ketë vendosur lidhur me ankesën e ankueses të datës 09.03.2023.


Në kuptim të pranushmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 të më të cilin parashihet se: *1. Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet..."* dhe si rrjedhojë mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton së ankuesja në cilësi të kandidates për pranim në shërbimin civil, për shkak të mos përfshirjes në testin më shkrim, duhej të parashtronte fillimisht ankesë të Komuna e Prishtinës, e me tej në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave ankesa e ushtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e palejueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.476/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së